

KËSHILLI DREJTUES

**V E N D I M**

**Nr. 7, datë 16.03.2015**

**Për miratimin e planit strategjik  
të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave  
për vitet 2015-2017**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

---

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Planin Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2015-2017, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e Planit Strategjik në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.
3. Ngarkohen strukturat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Martin Blushi  
**Sekretar**

Genci Mamani  
**Kryetar**



AGJENCIA  
E SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE

# **PLANI STRATEGJIK 2015 - 2017**



Në hartimin e Planit Strategjik 2015-2017, Agjencia konsideroi me kujdes dhe u bazua në vizionin, misionin si dhe vlerat e objektivat publikë të skemës së sigurimit të depozitave, të cilat qëndrojnë në themel të të gjithë veprimtarisë së institucionit.

## VIZIONI i AGJENCISË

Të jemi siguruesi i depozitave që meriton besimin e publikut.

## MISIONI i AGJENCISË

Të mirëadministrojmë skemën e sigurimit të depozitave<sup>1</sup>.

## VLERAT e AGJENCISË

Veprojmë me **Integritet** në përmbushje të misionit.

Punojmë në **Ekip** për të forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin efektiv.


Jemi të **Përkushtuar** për mirëinformimin e publikut dhe kompensimin e shpejtë.

**Transparentë** në kulturën tonë të punës.

Administrojmë me **Përgjegjshmëri** burimet financiare.


---

<sup>1</sup> Në Statutin e Agjencisë përcaktohet që "Misioni i Agjencisë është administrimi i skemës së sigurimit të depozitave me qëllim përmbushjen e objektivave publikë të skemës në mbështetje dhe në zbatim të ligjit". Me qëllim komunikimin efektiv me grupet e interesit në këtë dokument është paraqitur një version i thjeshtë.



## **TRYEZA E LËNDËS**

PËRMBLEDHJE .....	4
FAKTORËT KYÇ TË SUKSESIT .....	6
ANALIZA E FORCAVE, DOBËSIVE, MUNDËSIVE DHE KËRCËNIMEVE (SWOT) ..	7
STRATEGJITË, OBJEKTIVAT DHE PROJEKTET .....	12
ADMINISTRIMI I RREZIQEVE .....	15
PËRFUNDIM.....	19
ANEKSI 1 - Tabela e objektivave dhe projekteve të Planit Strategjik 2015-2017 .....	20




## PËRMBLEDHJE

Plani Strategjik 2015-2017 i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave synon të japë një parashikim të qartë dhe të strukturuar të drejtimit të veprimtarisë së Agjencisë gjatë këtij trevjeçari. Prioritet për skemën e sigurimit gjatë këtyre tre viteve, dhe mandatit të Agjencisë si administratore të saj, do të vazhdojë të mbetet përgatitja për kompensim efektiv të depozituesve në rast nevoje. Në përmbushje të këtij mandati, plani strategjik paraqet një pasqyrë të aktivitetit të Agjencisë për këtë periudhë, e cila do të përqendrohet në ndjekjen e një strategjie konkrete për realizimin e objektivave afatshkurtër dhe afatmesëm të mirë përcaktuar.

Plani Strategjik është hartuar duke përdorur një përjasje sfiduese por dhe realiste, e cila u bazua në dy shtylla kryesore. Së pari, janë konsultuar parimet themelore për sistemet efektive të sigurimit të depozitave nga Organizata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave (IADI), si dhe janë ndjekur praktikrat dhe standardet më të mira ndërkombëtare të siguruesve të depozitave. Kjo është sfida e Agjencisë. Së dyti, bazuar në kapacitetet aktuale dhe eksperiencat e kaluara, është kryer një analizë SWOT, e cila identifikon forcat dhe dobësitë e Agjencisë, si dhe mundësitë dhe kërcënimet me të cilat përballlet Agjencia në përmbushje të këtij Plani Strategjik. Ky është realiteti i Agjencisë.

Analiza e SWOT pasqyron *status quo* të kapaciteteve të Agjencisë në raport me Planin Strategjik. Në këtë kuadër, SWOT evidenton si *forca* kryesore të Agjencisë fondin e sigurimit të depozitave dhe disponueshmërinë e mjeteve financiare, kapacitetet operacionale dhe përkushtimin e strukturave të Agjencisë, si dhe bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ndër të tjerë me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare në vend dhe organizatat ndërkombëtare të siguruesve të depozitave. Megjithatë, sipas analizës, padyshim ekzistojnë *mundësitë* për përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit të skemës së sigurimit në përputhje me praktikrat më të mira ndërkombëtare, veçanërisht *acqui* e Bashkimit Europian, dhe intensifikimin e marrëdhënieve me partnerët e Agjencisë dhe grupet e interesit. Nga ana tjetër, *dobësitë* e Agjencisë në përmbushje të planit strategjik karakterizohen nga mungesa e përvojave të mëparshme të ngjarjeve të sigurimit, infrastruktura ende e papërfunduar për rastet e kompensimit, si dhe ngritja dhe ruajtja e standardeve dhe procedurave operacionale të qarta dhe efikase. Ndërkohë, *kërcënimet* në përmbushje të planit strategjik përqendrohen kryesisht në qëndrueshmërinë e sistemit financiar në vend dhe zhvillimet në subjektet anëtare, ndryshimet e kuadrit rregullativ dhe ligjor në të cilat Agjencia mbështet aktivitetin e saj, efikasitetin e mekanizmave ligjzbatuese, si dhe qëndrueshmërinë e financave publike.

Për trevjeçarin 2015-2017, faktorët që do të ndikojnë në suksesin e Agjencisë janë: (i) *14 ditë për të kompensuar depozituesit në shumën ligjore*. Element i domosdoshëm është përgatitja për kompensim sipas kuadrit ligjor e rregullativ, simulimet dhe trajnimet, dhe bashkëpunimi




ndërinstitucional me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare në vend për të qenë vigjilentë dhe gati në çdo kohë; (ii)  $\pm 10\%$  variancë e realizimit të buxhetit vjetor. Agjencia synon përmirësimin e vazhdueshëm të efikasitetit operacionale, nëpërmjet një planifikimi realist, si dhe menaxhimit me efektivitet të fondeve dhe burimeve financiare të saj; (iii)  $2\%-4\%$  rritje të ndërgjegjësisë të publikut për skemën e sigurimit. Vlerësohet se informimi i mirë i publikut për skemën dhe rolin e Agjencisë është thelbësor në forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Në kuadër të përmbushjes së këtyre faktorëve, plani strategjik evidenton strategjitë tek të cilat do të mbështetet veprimtaria e Agjencisë për këtë trevjeçar, të cilat janë:

- a) Gatishmëria për kompensim. Element thelbësor është bashkëpunimi ngushtë me anëtarët e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, veçanërisht Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, synohet përmirësimi dhe testimi infrastrukturës ligjore, informatike dhe operacionale të Agjencisë për realizimin e procesit të kompensimit brenda afateve. Në këtë kuadër, prioritet është përmirësimi i cilësisë së të dhënave të depozituesve nga subjektet anëtare të skemës.
- b) Menaxhimi efektiv i mjeteve financiare. Përmirësimi i metodave të administrimit të rreziqeve lidhur me portofolin e investimeve, likuiditetin, kredinë dhe shpërndarjen e rrezikut në sistemin bankar. Synohet planifikim realist dhe monitorim i vazhdueshëm i treguesve financiarë, si dhe identifikimi i treguesve standard të performancës financiare.
- c) Ndërgjegjësimi publikut. Kryerja e anketimeve periodike për matjen e nivelit të ndërgjegjësisë të publikut. Hartimi i strategjive për një komunikim të vazhdueshëm dhe efektiv me grupet e interesit.
- d) Zgjerimi i skemës së sigurimit të depozitave. Përfshirja e shoqërive të kursim-kreditit dhe nisma për përfshirjen e SME-ve në skemë.
- e) Identifikimi i drejtimeve të reja për një administrim më efikas të Institucionit. Agjencia do të ndjekë standardet ndërkombëtare të mirëqeverisjes, transparencës dhe komunikimit. Gjithashtu, synohet angazhimi në projekte sociale me ndikim në komunitet.

Agjencia vlerëson se zbatimi i këtyre strategjive është pjesë thelbësore e përmbushjes së objektivit publik të skemës së sigurimit të depozitave, për kompensimin e saktë dhe në kohë të depozituesve të siguruar. Për realizimin e strategjive dhe objektivave të përcaktuara gjatë kësaj periudhe, Agjencia do të përqendrojë të gjitha përpjekjet dhe burimet e saj për forcimin e kapaciteteve operacionale. Gjithashtu, Agjencia do të vazhdojë angazhimin për të forcuar bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare dhe grupet e interesit, për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.



## FAKTORËT KYÇ TË SUKSESIT

Në përcaktimin e faktorëve kyç që do të ndikojnë në suksesin e Planit Strategjik 2015-2017 janë marrë në konsideratë mjedisi rregullativ në fuqi për skemën e sigurimit të depozitave dhe kapacitetet dhe burimet në dispozicion. Agjencia vlerëson se zbatimi i strategjive të përcaktuara në këtë strategji tre-vjeçare e sjell atë më afër realizimit të faktorëve që do të ndikojnë në suksesin e saj.

### **I. 14 (katërmbëdhjetë) ditë për të kompensuar depozituesit në shumën ligjore.**

Kompensimi i saktë dhe i shpejtë i depozituesve është arsyeja e ekzistencës së ASD-së. Në përputhje me misionin e saj dhe parimet themelore për sistemet efektive të sigurimit të depozitave, ASD ka përcaktuar si faktor kyç sukse si kompensimin e depozituesve në shumën ligjore brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga dita e vendosjes në likuidim të detyruar të institucionit financiar në paafësi pague. ASD është e angazhuar që në fund të trevjeçarit të mund të realizojë procese kompensimi me efikasitet dhe në kohë, për depozitat e siguruara në institucionet financiare të shpallura në falimentim, pjesë e skemës së sigurimit të depozitave. Gjithashtu zhvillon procedura simulimesh për të testuar, përmirësuar dhe garantuar efikasitetin e procedurave të saj. Në këtë mënyrë ASD kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

### **II. ± 10% variancë e realizimit të buxhetit vjetor.**

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, është në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të efikasitetit të saj operacionale. ASD është e angazhuar që, çdo vit, buxheti i saj i realizuar të mos ketë shmangie më të lartë se 10% nga buxheti i miratuar. Arritja e këtij treguesi kërkon:

- a. Planifikim sfidues dhe realist.
- b. Përmirësim të komunikimit dhe bashkëpunimit.
- c. Menaxhim efektiv të fondeve dhe burimeve të tjera të saj.

### **III. 2%-4% rritje e ndërgjegjësimit të publikut për Skemën e Sigurimit të Depozitave në Republikën e Shqipërisë.**

Veprimtaria e sigurimit të depozitave ka si element thelbësor besueshmërinë e publikut se kursimet e tyre janë të mbrojtura. Në këtë aspekt, ndërgjegjësimi i publikut është konsideruar si element shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për përmbushjen e objektivave publike të skemës së sigurimit të depozitave. Për këtë arsye ASD është e angazhuar që në periudhën e planifikuar të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit të publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave 2 deri në 4 %.



## ANALIZA E FORCAVE, DOBËSIVE, MUNDËSIVE DHE KËRCËNIMEVE (SWOT)

Puna për përcaktimin e drejtimeve strategjike, objektivave dhe projekteve që do të realizohen përgjatë periudhës së planifikuar, u parapri nga analiza e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që kanë ndikim në veprimtarinë e Agjencisë. Kjo analizë u mbështet, ndër të tjera, në vlerësimin e misionit FSAP të Bankës Botërore dhe FMN-së për nivelin e përputhshmërisë së institucionit me parimet bazë për skema të sigurimit të depozitave. Gjithashtu, u konsiderua përvoja e deritanishme e Agjencisë në administrimin e sfidave dhe vlerësimi i mjedisit operacional në të cilin ajo ushtron aktivitetin e saj.

<b>Forcat</b>	<b>Dobësitë</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkëpunimi shumëpalësh</li> <li>2. Përkushtimi i strukturave të Agjencisë</li> <li>3. Rritja e shëndetshme e fondit të sigurimit dhe disponueshmëria e mjeteve financiare</li> <li>4. Zhvillimi i kapaciteteve operationale</li> <li>5. Përmirësimi i kornizës ligjore</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të dhëna historike dhe përvoja të mëparshme</li> <li>2. Infrastruktura për kompensim</li> <li>3. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërsektorial në Agjenci</li> <li>4. Përditësimi i politikave dhe procedurave operationale</li> <li>5. Menaxhimi i rreziqeve</li> </ol>
<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pranimi gjerësisht i parimeve themelore dhe direktivave të Bashkimit Evropian mbi sigurimin e depozitave</li> <li>2. Angazhimi i GKSF dhe partnerëve ndërkombëtarë</li> <li>3. Rritja e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimit të grupeve të interesit</li> <li>4. Zgjerimi i përdorimit të teknologjisë</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përqendrim i rrezikut, mbikëqyrje e relaksuar, dhe ekspozim i sektorit financiar</li> <li>2. Paqëndrueshmëria e kuadrit rregullator</li> <li>3. Efikasiteti i mekanizmave për zbatimin e kuadrit ligjor dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve</li> <li>4. Rreziku i tregut dhe qëndrueshmëria e financave publike</li> </ol>





## I. Forcat e ASD në përmbushje të Planit Strategjik


- 1. Bashkëpunimi shumëpalësh** – Agjencia, si anëtare defakto e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e saj me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Gjithashtu Agjencia, si anëtare me të drejta të plota e Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) dhe Forumit European të Siguruesve të Depozitave (EFDI), përthith praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave. Me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe kapaciteteve, Agjencia ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione homologe.
- 2. Përkushtimi i strukturave të Agjencisë** - Përmbushja e objektivave të Planit Strategjik është një proces gjithëpërfshirës që kërkon përkushtimin e strukturave të Agjencisë. Si rrjedhojë një nga fuqitë e Agjencisë është angazhimi treguar i të gjithë strukturave të Agjencisë, nga Këshilli Drejtues deri tek stafi, për nismat e ndërmarra nga Agjencia në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së sigurimit të depozitave dhe mirëqeverisjen e saj.
- 3. Rritja e shëndetshme e fondit të sigurimit dhe disponueshmëria e mjeteve financiare** - Fondi i sigurimit të depozitave është rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga krijimi i Agjencisë në vitin 2002 dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka lindur nevoja për përdorimin e tij. Në mbështetje të dispozitave të ligjit “Për Sigurimin e Depozitave”, Agjencia ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë për sigurimin e mjeteve likuide dhe garantimin e fondeve të nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore në rast ngjarje sigurimit. Gjithashtu me qëllim diversifikimin e burimeve të financimit dhe rritjen e nivelit të mbulimit, gjatë vitit 2014 Agjencia ka nënshkruar një marrëveshje kredie me BERZH. Disponueshmëria e mjeteve financiare, për më tepër, krijon mundësi për alokimin e burimeve të nevojshme në realizimin e objektivave të Planit Strategjik.
- 4. Zhvillimi i kapaciteteve operationale** – Agjencia ka ndërmarrë një sërë iniciativash për përmirësimin e kapaciteteve të saj operationale. Ngritja dhe implementimi i sistemit informatik për raportim dhe kompensim, ndryshimet në strukturën organizative dhe qeverisjes, si dhe rritja e pavarësisë financiare kontribuojnë në efikasitetin e veprimtarisë së Agjencisë në përmbushje të objektivave strategjik.
- 5. Përmirësimi i kornizës ligjore** – Në vitin 2014 u miratua ligji i ri “Për Sigurimin e Depozitave” i cili, në përputhje dhe me rekomandimet e FMN dhe Bankës Botërore, krijon bazën ligjore për përmirësimin e rregullave të funksionimit të skemës së sigurimit të depozitave. Ky ligj ka krijuar hapësirën e nevojshme për zhvillimin e vazhdueshëm të skemës së sigurimit të depozitave në



vendin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Skema Efektive të Sigurimit të Depozitave, si dhe me Direktivën 2014/49/BE të Bashkimit Europian “Mbi skemat e garantimit të depozitave”.

## **II. Dobësitë e ASD në përmbushje të Planit Strategjik**

- 1. Të dhëna historike dhe përvoja të mëparshme** – Agjencia e Sigurimit të Depozitave është një institucion relativisht i ri, i cili nuk është përballur me ngjarje sigurimi. Përvojat e mëparshme dhe ekzistenca e të dhënave historike mundëson parashikime dhe hartimin e strategjive më të sakta dhe realiste në përmbushje të objektivave, bazuar në kushtet e ambientit në të cilat Agjencia operon. Gjithashtu Agjencia ka ndërmarrë për herë të parë gjatë vitit 2014 matjen e ndërgjegjësimit të publikut për skemën e sigurimit çka vendos bazat për ndërtimin e një plani veprimi efikas në lidhje me këtë objektiv.
- 2. Infrastruktura për kompensim** – Kryerja e procesit të kompensimit brenda afateve të vendosura kërkon ngritjen dhe testimin e infrastrukturës së nevojshme që mbështet këtë proces dhe bashkërendon punën me aktorë të jashtëm që janë pjesë e tij. Agjencia është në proces rishikimi dhe testimi të kuadrit rregullator dhe kontraktual që mundëson një proces efikas dhe të qartë për të gjithë aktorët e përfshirë në të.
- 3. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërsektorial në Agjenci** – Realizmi i objektivave strategjik kërkon bashkëpunim dhe koordinim efikas ndërsektorial në Agjenci. Identifikimi i projekteve kyçe, planifikimi sfidues dhe realist, dhe ndjekja dhe monitorimi i tyre në kohë kërkon përmirësimin e vazhdueshëm të linjave të komunikimit dhe fleksibilitetit në aktivitetin e përditshëm të njësive organizative të Agjencisë në funksion të përmbushjes së objektivave të përbashkëta të Planit Strategjik.
- 4. Përditësimi i politikave dhe procedurave operacionale** – Rishikimi periodik dhe përshtatja me praktikën më të mira të politikave dhe procedurave operacionale që drejtojnë veprimtarinë e Agjencisë është parësore në rritjen e efikasitetit operacional, përmirësimin e ambientit të kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve të Agjencisë. Politika dhe procedura të qarta dhe të ndërtuara në mënyrë efikase reduktojnë gabimet, thjeshtojnë proceset e punës, dhe mundësojnë reduktimin burimeve të angazhuara në aktivitete dytësore dhe ridrejtimin e tyre në përmbushje të projekteve strategjike.



- 5. Menaxhimi i rreziqeve** – Përmbushja e objektivave strategjike mbart në vetvete rreziqe të cilat duhet të mirë administrohen nga Agjencia. Identifikimi i qartë i rreziqeve si dhe hartimi dhe zbatimi i masave për mbajtjen e tyre brenda parametrave të pranueshëm ndihmon në përmbushjen sasiore dhe cilësore të projekteve të ndërmarra. Marrja e rreziqeve të tepruara në përmbushjen e objektivave afatmesëm mund të shkaktojnë barrë të paarsyeshme mbi Agjencinë dhe aktorët e tjerë të ndërlidhur me të.

### III. Mundësitë në përmbushje të Planit Strategjik

- 1. Pranimi gjerësisht i parimeve themelore dhe direktivave të Bashkimit Evropian mbi sigurimin e depozitave** – Parimet themelore për skemat e sigurimit të depozitave janë certifikuar tashmë si standarde të gjithëpranuara në fushën e sigurimit të depozitave. Vënia e tyre në zbatim është një garanci e qëndrueshme për përmirësimin e vazhdueshëm dhe harmonizimin e praktikave më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu, angazhimi i BE për skema sigurimi efikase ofron një mundësi të qartë për hapat integruese të Shqipërisë në këtë drejtim.
- 2. Angazhimi i GKSF dhe parterëve ndërkombëtarë** – Si anëtare defakto e GKSF, Agjencia kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit. Angazhimi dhe koordinimi përmes ndërveprimit periodik të pjesëmarrësve të rrjetit të sigurisë financiare, mundëson garantimin e një skeme të qëndrueshme dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj. Në këtë linjë, partnerët kyç financiar të Shqipërisë, FMN dhe BB, janë të angazhuar në mbështetje të forcimit të sistemit financiar në përgjithësi dhe skemës së sigurimit të depozitave në veçanti.
- 3. Rritja e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin të grupeve të interesit** – Iniciativat e ndërmarra së fundmi nga ASD në fushën e ndërtimit dhe mbajtjes së linjave efikase të komunikimit më grupet e interesit (si Institucionet financiare, Parlamenti, Qeveria Shqiptare, Banka e Shqipërisë, Media, etj.) dhe mundësia për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre, përbëjnë një mundësi reale për përmbushjen e objektivave të Planit Strategjik. Për më tepër, aksesin në rritje të publikut në informacionin financiar ka një ndikim të konsiderueshëm në përmbushjen me efikasitet të objektivave të skemës.
- 4. Zgjerimi i përdorimit të teknologjisë** – Diversifikimi i burimeve të komunikimit përmes rritjes së përdorimit të teknologjisë së informacionit nga publiku i gjerë dhe aktorët me të cilët Agjencia ndërvepron, krijojnë mundësi për efikasitet në rritje të iniciativave që Agjencia do të ndërmarrë në përmbushje të objektivave të saj strategjike afatmesëm dhe afatgjatë.



#### **IV. Kërcënimet në përmbushje të Planit Strategjik**

- 1. Përqendrim i rrezikut, mbikëqyrje e relaksuar, dhe ekspozim i sektorit financiar –** Efikasiteti i skemës së sigurimit të depozitave ndikohet nga zhvillimet në subjektet anëtarë si dhe nga qëndrueshmëria e sektorit financiar përballë tronditjeve të mundshme. Përqendrime të ekspozimit në aktorë të veçantë të tregut do të zvogëlonin efikasitetin e skemës. Mos adresimi i sfidave të identifikuar nga FMN dhe BB në Programin e Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) në lidhje me përmirësimin e ambientit rregullator, ekspozimin e sektorit ndaj kredive me probleme, përdorimin e monedhës EUR, dhe rritjen e efikasitetit të mbikëqyrjes për institucionet bankare dhe jo bankare, do të përbente një sfidë për përmbushjen e objektivave të Planit Strategjik.
- 2. Paqëndrueshmëria e kuadrit rregullator –** Agjencia ushtron veprimtarinë e saj të përditshme në përputhje dhe në zbatim të akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore (si p.sh. Kodi i Punës, Ligji për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, Ligji për tatimet, Ligji për kontabilitetin, Ligji për prokurimin publik, etj.). Paqëndrueshmëria e kuadrit rregullator ose paparashikueshmëria e lartë e ndryshimeve përkatëse përbën kosto për secilin aktor që drejtohet prej tyre dhe si rrjedhojë mund të shkaktonte vonesa në përmbushje të objektivave të Planit Strategjik.
- 3. Efikasiteti i mekanizmave për zbatimin e kuadrit ligjor dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve –** Zbatimi efikas i kuadrit ligjor dhe marrëdhënieve kontraktuale është predispozitë parësore për një sistem financiar të qëndrueshëm dhe efikasitetin e veprimtarisë së aktorëve të ndryshëm. Reformat për mekanizma efikas të zbatimit të ligjit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbeten disa nga sfidat kryesore të vendit. Në aktivitetin e përditshëm të Agjencisë dhe veçanërisht në ngjarje siguri mbështetja në këto mekanizma mbetet e qenësishme dhe mos funksionimi efikas i tyre mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e objektivave të Planit Strategjik.
- 4. Rreziku i tregut dhe qëndrueshmëria e financave publike –** Në administrimin e mjeteve financiare, Agjencia është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh financiare, ku më të rëndësishmit janë rreziku i tregut, rreziku i kredisë dhe i likuiditetit. Ekspozimi në instrumente borxhi të Qeverisë Shqiptare, në kushtet e aktivitetit të limituar në tregun sekondar dhe zhvillimeve ekonomike, mund të ndikohet negativisht nga paqëndrueshmëria e financave publike. Gjithashtu rritja e paqëndrueshmërisë së financave publike mund të kufizonte aftësinë e Qeverisë Shqiptare për të përmbushur në kohë përgjegjësitë në përputhje me ligjin dhe marrëveshjet e nënshkruara.



## STRATEGJITË, OBJEKTIVAT DHE PROJEKTET

---

Për periudhën e planifikuar, strategjitë janë përqendruar në nisma dhe projekte, të cilat synojnë përmirësimin e efikasitetit operacional dhe gatishmërisë së Agjencisë. Këto strategji mbështeten në përmirësimin e bashkëpunimit me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare; rritjen e aftësive dhe kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe administrimin efikas të burimeve financiare; si dhe përmirësimin e nivelit të informimit të publikut. Përcaktimi i drejtimeve strategjike është shumë i rëndësishëm me qëllim identifikimin e projekteve/nismave, të cilat do të përforconin kapacitetet e Agjencisë për të përmbushur vizionin dhe misionin e saj.

### I. Gatishmëria e Agjencisë për kompensim

Bashkëpunimi me anëtarët e tjerë të rrjetit të sigurisë financiare, e veçanërisht marrëdhënia e ngushtë e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, është konsideruar si një drejtim strategjik i një rëndësie kritike. Kjo marrëdhënie është bazë për marrjen në kohë të informacionit në lidhje me depozitat dhe depozituesit si dhe sigurimin e likuiditeteve të nevojshme për realizimin me sukses të një procesi kompensimi. Kjo merr një rëndësi akoma më të madhe duke marrë në konsideratë statistikën në lidhje me faktorët që pengojnë realizimin në kohë të një procesi kompensimi dhe veçanërisht rëndësinë jetike që ka marrja në kohë e të dhënave të depozituesve në një ngjarje sigurimi.<sup>2</sup>

Si faktor kyç në këtë bashkëpunim shihet dhe adresimi i problemit të mungesës së të dhënave identifikuese të depozituesve (veçanërisht numri personal dhe adresa), duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka ky problem në funksion të plotësimit të mandatit të Agjencisë. Adresimin e kësaj çështjeje Agjencia synon ta realizojë me mbështetjen dhe bashkëpunim e ngushtë të Autoritetit Mbikëqyrës dhe të Ministrisë së Financave.

Plani ka një tjetër objektiv strategjik të rëndësishëm për realizimin e mandatit të Agjencisë, rritjen e gatishmërisë dhe efektivitetit operacional. Agjencia gjatë këtij trevjeçari synon të forcojë gatishmërinë operationale si dhe të gjejë metoda për rritjen e ekspertizës dhe aftësive të stafit. Efektiviteti i operationeve dhe proceseve është thelbësor për të përmbushur detyrat e mandatit të Institucionit. Duke patur parasysh këtë synim, forcimi i kuadrit rregullator dhe proceseve për të mbështetur një kompensim të shpejtë dhe të saktë do të konsiderohet edhe gjatë këtyre tre viteve një objektiv i rëndësishëm i Agjencisë.

---

<sup>2</sup> Enhanced Guidance for Effective Deposit Insurance Systems: Reimbursement Systems and Process, pg. 14; November 2012



Gjithashtu, me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, është e rëndësishme të kesh zgjidhje efektive informatike të cilat të mbështesin misionin dhe vizionin e Agjencisë. Dhe këto do të jenë pjesë e objektivave të planit strategjik të Agjencisë për tre vitet në vijim.

Në tre vitet në vijim, Agjencia do të forcojë shkallën e gatishmërisë nëpërmjet simulimeve. Nëpërmjet tyre do të mund të identifikojë mundësitë për forcimin dhe përmirësimin e proceseve apo infrastrukturës së saj.


## **II. Menaxhim efektiv i mjeteve financiare**

Strategjia e Agjencisë konsiston në monitorimin e vazhdueshëm të shpërndarjes së rrezikut në sistemin bankar, siç reflektohet në dy dimensione, në atë të profilit individual të secilit subjekt dhe në rrezikun e sistemit, që përfshin edhe ndërlydhjet e tyre. Profilet individuale të rrezikut të subjekteve të siguruar krijohen bazuar në treguesit sasior të raportuar nga Autoriteti Mbikëqyrës, kryesisht tregues mbi situatën ekonomiko-financiare të bankave të nivelit të dytë, ndërkohë që ndjekja në kohë dhe sistematike e këtyre profileve evidenton edhe veçoritë dalluese në administrim në secilën prej tyre.

Përtej ndjekjes së profileve individuale të rrezikut, analiza synon të influencojë në politikën e investimit të mjeteve financiare të Agjencisë duke siguruar në çdo rast dhe kohë gatishmëri në kompensim. Njohja paraprakisht e shpërndarjes së rrezikut në sistemin bankar mundëson përshtatje më të mirë të politikave të investimit duke administruar me efikasitet rrezikun e likuiditetit. Menaxhimi më me efektivitet i rreziqeve financiare të portofolit të Agjencisë, do të jetë një nga prioritetet në arritjen e objektivave strategjike të saj.

Një nga faktorët kyç të identifikuar që do t' i mundësojë Agjencisë përmbushjen me sukses të mandatit të saj është realizimi i buxhetit me variancë  $\pm 10\%$ .

Për të realizuar këtë faktor, Agjencia do të kryejë një rishikim të procesit të planifikimit të buxhetit, i cili do të mundësojë përfshirjen aktive të të gjithë strukturave. Të gjitha projektet do të ndiqen nga struktura përkatëse të Agjencisë, të cilat kanë kërkuar përfshirjen e tij në buxhet, duke bërë raportim periodik çdo tre muaj. Gjithashtu, në tre vitet në vijim, Agjencia do të kryejë rishikim periodik, zbatim dhe monitorim efektiv të treguesve financiarë të dakortësuar të performancës, të cilët nxisin përdorimin me efikasitet të mjeteve financiare dhe minimizimin e variancave dhe uljen e vonesave në realizimin e tyre.



### **III. Ndërgjegjësimi publikut**

Me qëllim që sistemi i sigurimit të depozitave të jetë efektiv është thelbësore që publiku të informohet në mënyrë të vazhdueshme lidhur me skemën e sigurimit të depozitave, përfitimet dhe kufizimet e saj. Duke marrë në konsideratë këtë parim themelor të standardeve ndërkombëtare, Agjencia do të hartojë dhe zbatojë strategjinë e saj të komunikimit si në kohë të qeta ashtu edhe në rast ngjarje sigurimi. Strategjia e komunikimit do të përqendrohet në identifikimin e audiencave të synuara, adresimin në mënyrën e duhur të informacionit dhe mekanizmat që do të përdoren për këtë qëllim.

Për të vlerësuar efektivitetin e strategjisë së komunikimit, me qëllim rishikimin në drejtim të përmirësimit të efikasitetit të saj, do të kryhen studime vjetore të nivelit të ndërgjegjësimit të publikut. Studimet vjetore do të synojnë matjen e informimit të publikut në lidhje me skemën e sigurimit, Agjencinë si administratore e saj, shumën ligjore të sigurimit, etj.

### **IV. Identifikimi i drejtimeve të reja për një administrim më të mirë të Institucionit**

Në kuadër të identifikimit të drejtimeve të reja, Agjencia synon të kryejë vetëvlerësim për përputhshmërinë e skemës me parimet themelore të skemave efektive të sigurimit të depozitave.

Pjesë e rëndësishme e një administrimi të mirë të Institucionit është menaxhimi eficient i burimeve njerëzore. Për këtë qëllim, Agjencia, gjatë 2015/2017, do të zhvillojë një plan të ri Strategjik për Burimet njerëzore, për të siguruar angazhimin dhe optimizimin e efikasitetit të stafit, për arritjen e objektivave. Plani strategjik do të krijojë mundësi për një zhvillim më të mirë profesional, do të rrisë dhe zhvillojë aftësitë e punonjësve nëpërmjet përvetësimit të praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnimeve të ndryshme si dhe procesit të testimit të vazhdueshëm. Gjithashtu, pjesë e planit strategjik të administrimit të burimeve njerëzore, është përfshirja e të gjithë punonjësve në realizimin e objektivave, nëpërmjet përmirësimit të komunikimit si dhe të inkurajimit të punës në grup.



## ADMINISTRIMI I RREZIQEVE

---

Administrimi efikas i rreziqeve është një proces shumë i rëndësishëm në zbatimin me sukses të Planit Strategjik. Ky proces përfshin identifikimin, vlerësimin, adresimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të rreziqeve të cilët ndikojnë në përmbushjen e një ose më shumë prej drejtimeve strategjike të Agjencisë. Më poshtë paraqiten në formë të përmbledhur rreziqet kryesore të pranishme në veprimtarinë e Agjencisë.

### Kategoritë dhe nën kategoritë e rreziqeve:

#### ❖ Rreziqet financiare

Përfshijnë grupin e rreziqeve që rezultojnë nga luhatjet në vlerën e aseteve dhe detyrimeve financiare të Agjencisë. Kategoritë e rreziqeve financiare që kushtëzohen nga faktorë të jashtëm konsistojnë në rreziqet e tregut, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e kredisë.


- **Rreziqet e tregut** – Janë rreziqe të humbjeve për shkak të lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit, kursit të këmbimit dhe çmimeve të tregut.
- **Rreziku i likuiditetit** - Është rreziku që Agjencia të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve e saj financiare, që shlyen duke dhënë para apo një aktiv tjetër financiar, si në veprimtarinë e përditshme dhe në rast ngjarje sigurimi.
- **Rreziku i kredisë** – Është rreziku i humbjeve financiare nëse pala tjetër në një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

#### ❖ Rreziqet e sigurimit

Ky grup u referohet rreziqeve që lidhen me aftësinë e institucionit për të kryer vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve që ekzistojnë në lidhje me ofrimin e shërbimit të sigurimit të depozitave.

- **Rreziku i vlerësimit dhe monitorimit** – Rreziku që Agjencia të mos kryejë në kohë identifikimin, monitorimin dhe raportimin mbi subjektet anëtarë me rrezik të lartë.
- **Rreziku i kompensimit** – I referohet gatishmërisë për të kryer një proces kompensimi efektiv, në përputhje me mandatin e Agjencisë.






- **Rreziku ligjor**– I referohet rrezikut që lidhet me efektivitetin e ligjit “Për sigurimin e depozitave” dhe akteve të tjera që rregullojnë aktivitetin e Agjencisë.

#### ❖ **Rreziqet operacionale**

Grupi i rreziqeve që lidhen me proceset e brendshme të institucionit, me rrezikun njerëzor, të teknologjisë së informacionit, kërkesat e përputhshmërisë ligjore, sigurisë së informacionit, etj, që mund të ndikojnë në përmbushjen e mandatit të Agjencisë.

- **Rreziku i përputhshmërisë ligjore** - i referohet ngjarjeve të rrezikut që lidhen me dështimin e Agjencisë për të kryer aktivitetin e saj, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi, me udhëzimet, manualet, politikat e brendshme, etj.
- **Rreziku i sigurisë së informacionit** - i referohet ngjarjeve të rrezikut që çënojnë sigurinë e informacioneve konfidenciale.
- **Rreziqet e teknologjisë së informacionit** – janë ngjarje me rrezik që lidhen me dëmtimet e sistemeve IT dhe paaftësisë së tyre për të mbështetur efektivisht institucionin në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave.
- **Rreziqet njerëzore** - u referohen ngjarjeve me rrezik që rezultojnë nga pamjaftueshmëria në kompetenca, në kapacitete apo performancë, apo nga trajtimi i papërshtatshëm i personelit.
- **Rreziqet e procesit** – ngjarje me rrezik që kanë të bëjnë me zbatim jokorrekt të procesit, shkelje ose mangësi në politikat, procedurat dhe kontrollet e tij.
- **Rreziku i sigurisë fizike** – janë ngjarje me rrezik që lidhen me pamundësinë e Agjencisë për të garantuar sigurinë e personelit dhe asetëve të saj.



### ❖ Rreziqet e reputacionit


U referohen ngjarjeve që mund të kenë ndikim negativ në besimin e grupeve të interesit, lidhur me aftësinë e institucionit për të përmbushur objektivat.

- **Rreziku mediatic** – lidhet me ndikimin negativ që sjellin raportimet mediatike, si deformimi dhe pamjaftueshmëria e informacionit, raportimet kontradiktore, etj.
- **Rreziku i perceptimit/imazhit** – ngjarje që lidhen me rënien e ndërgjegjësimit publik dhe efektivitetit të politikave për njohjen e rolit të institucionit.

### ❖ Rreziqet strategjike dhe të drejtimit

Ky grup u referohet rreziqeve që ndikojnë në përmbushjen e drejtimeve strategjike të institucionit të përcaktuara në Planin Strategjik, si dhe rreziqet që mund të çenojnë efektivitetin e proceseve dhe strukturave të qeverisjes.

- **Rreziqet e jashtme** – ngjarje të jashtme të pa kontrollueshme, të cilat kërcënojnë aftësinë e institucionit për kryerjen e aktivitetit të përditshëm dhe përmbushjen e objektivave.
- **Rreziqet e qeverisjes** - janë ngjarje me rrezik që lidhen me marrëdhëniet e institucionit me grupet e interesit, me Këshillin Drejtues dhe mjedisin e kontrollit të brendshëm.
- **Rreziku strategjik** – u referohet ngjarjeve me rrezik që lidhen me vendime strategjike të pafavorshme, zbatimin e papërshtatshëm të vendimeve, ose mospërshtatje ndaj ndryshimeve në ambientin operativ.
- **Rreziku i vazhdimësisë së aktivitetit** – u referohet ngjarjeve që shkaktojnë probleme në veprimtarinë e përditshme të punonjësve, pajisjeve, hapësirave, ose aktiviteteve operacionale, për shkaqe të ndryshme, të cilat pengojnë vazhdimin normal të veprimtarisë.



Rreziqet e identifikuara do të pasqyrohen në vlerësimet periodike të Planit Strategjik të Agjencisë, ku do të përfshihen masat e marra për parandalimin dhe minimizimin e tyre. Gjatë periudhës tre vjeçare, do të monitorohet ecuria e tyre dhe do të vlerësohet efekti i masave të marra. Rreziqet do të vlerësohen bazuar në klasifikimin si më poshtë:

<b>Të pranueshëm</b>	Niveli i rrezikut është i pranueshëm dhe ekzistojnë praktika të përshtatshme për administrimin e tij.
<b>Të menaxhueshëm</b>	Rreziqet që kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve për t'i minimizuar, dhe për të cilët po ndërmerren masa për menaxhimin e tyre
<b>Kërkojnë vëmendje</b>	Rreziqet që kërkojnë vëmendje të veçantë, dhe/ose nismat e ndërmarra më parë për administrimin e tyre nuk janë implementuar plotësisht, megjithëse po ndërmerren masa të përshtatshme për adresimin e tyre në kohë.
<b>Shqetësim serioz</b>	Niveli i rrezikut është i papranueshëm dhe mund të përfshijë boshllëqe të konsiderueshme që ekzistojnë në procedurat dhe kontrollet për menaxhimin e tyre




## PËRFUNDIM

---


Strategjia 2015-2017 e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave duhet konsideruar si një udhërrëfyes, i cili përcakton drejtimin strategjik që institucioni duhet të ndjekë për të realizuar me sukses dhe efikasitet objektivat dhe mandatin ligjor. Nismat e planifikuara në këtë Plan mund të vihen në zbatim me angazhimin e plotë të gjithë strukturave të Agjencisë. Ngritja, përmirësimi i vazhdueshëm dhe përdorimi me efikasitet i proceseve standarde të punës dhe infrastrukturës së nevojshme, identifikuar në këtë Plan, do të jenë prioritet për të gjitha strukturat e institucionit. Megjithatë, duhet theksuar se, në rast të ngjarjeve, të cilat do të kërkonin ri-përqendrimin e burimeve në dispozicion, mund të lindë nevoja e rishikimit të prioriteteve të projekteve të parashikuara në këtë Plan Strategjik. Duke marrë në konsideratë sa më sipër, Agjencia do të vazhdojë të monitorojë mjedisin e saj operacional, për t'u siguruar që rreziqet që mund ta pengojnë në realizimin e këtij Plani do të identifikohen në kohë dhe menaxhohen me kujdes duke synuar minimizimin e efektit të tyre.

Bazuar në faktorët kyç të suksesit dhe strategjitë e identifikuar në Planin Strategjik 2015-2017, Agjencia do të vazhdojë të punojë në drejtim të rritjes së efikasitetit të marrëdhënies me të gjithë aktorët e përfshirë dhe përmirësimit dhe përditësimit të kapaciteteve të saj në të gjitha aspektet. Të gjitha nismat dhe projektet e renditura në këtë dokument, kanë dy synime kryesore; (i) rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe efikasitetit të Agjencisë me qëllim krijimin e aksesit të shpejtë të depozituesve në kursimet e tyre, dhe; (ii) kontributin në rritjen e besueshmërisë së publikut në stabilitetin e sistemit financiar duke promovuar praktikat më efikase për ndërgjegjësimin e publikut.



ANEKSI 1 - Tabela e objektivave dhe projekteve 2015-2017


Strategjitetë	Objektivat strategjikë	Projektet	V. 2015	V. 2016	V. 2017
<b>Gatishmëria e Agjencisë për kompensim</b>	Bashkëpunim i ngushtë me GKSF për marrjen në kohë të informacionit në lidhje me institucionin me probleme dhe sigurimin në kohë të mjeteve financiare likuide.	Rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë	Nënshkrim	Zbatim	Zbatim
		Plan për raportimet periodike të Agjencisë në GKSF	Hartim	Zbatim	Zbatim
	Përmirësimi dhe testimi i infrastrukturës ligjore, informatike dhe operacionale të Agjencisë për realizimin e procesit të kompensimit brenda afateve të synuara.	Plani i kontigjencës për likuiditet për çdo subjekt anëtar të skemës, në rast të një ngjarjeje sigurimi.	Miratim	Përditësim	Përditësim
		Rishikimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator për kompensim	Miratim	Përditësim	Përditësim
		Testimi i stafit për realizimin e një procesi kompensimi	Zbatim	Zbatim	Zbatim
		Kryerja e simulimeve vjetore	Zbatim	Zbatim	Zbatim
		Automatizimi i dërgimit të të dhënave nga Agjencia tek BA	-	Propozim	Zbatim
		Ngjitja e një serveri back-up për ruajtjen e të dhënave në sistemin informatik të Agjencisë për raportim dhe kompensim	Zbatim	Mirëmbajtje	Mirëmbajtje
		Marrëveshje bashkëpunimi me subjekte publike/private për ndërmjetësimin në kryerjen e pagesave dhe për komunikimin me depozituesit në rast kompensimi.	Propozim	Zbatim	Zbatim



	Përmirësimi i cilësisë së mbajtjes së të dhënave për depozituesit nga subjektet anëtare të skemës.	Ndërgjegjësimi i Institucioneve Publike për t'iu mundësuar subjekteve të siguruara plotësimin/saktësimin e të dhënave identifikuese (numri personal, adresa e banimit).  Verifikime periodike në subjektet anëtare të skemës lidhur me saktësinë e mbajtjes së të dhënave.	Zbatim  Zbatim	Zbatim  Zbatim	Zbatim  Zbatim
<b>Menaxhim efektiv i mjeteve financiarë</b>	Përmirësimi i metodës së administrimit të rreziqeve lidhur me portofolin e investimeve, likuiditetin, kredinë dhe shpërndarjen e rrezikut në sistemin bankar	Procedurë për administrimin e rreziqeve të portofolit të investimeve te Agjencisë.	Miratim	Zbatim	Zbatim
		Metodologji për administrimin e rrezikut të likuiditetit për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë në rast kompensimit.	Zbatim	Zbatim	Zbatim
		Metodologji për monitorimin e shpërndarjes së rrezikut të bankave anëtare të skemës së sigurimit.	Zbatim	Zbatim	Zbatim
		Metodologji për administrimin e counterparty risk lidhur me operacionet që Agjencia kryen me bankat në sistem.	Zbatim	Zbatim	Zbatim
	Planifikim realist dhe monitorim i vazhdueshëm i buxhetit vjetor	Rishikimi i procedurave dhe politikave për hartimin dhe zbatimin e buxhetit	Miratim	Zbatim	Zbatim



		Ndërtimi i modeleve standarde të raportimit për realizimin e projekteve të buxhetit nga njësitë përgjegjëse	Miratim	Zbatim	Zbatim
	Identifikimi dhe dakortësimi i treguesve standard të performancës financiare	Studim për identifikimin e treguesve të performancës financiare bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare të përshtatshme për natyrën e institucionit.	Miratim	Zbatim	Zbatim
		Rishikimi periodik i treguesve financiarë të dakortësuar të performancës.	-	Zbatim	Zbatim
Ndërgjegjësimi i Publikut	Matja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut	Anketim vjetor për matjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut	Zbatim	Zbatim	Zbatim
	Komunikim i vazhdueshëm dhe efektiv me grupet e interesit	Strategji komunikimi me publikun	Miratim/Zbatim	Zbatim	Zbatim



Zgjerimi i skemës së sigurimit të depozitave	Përfshirja e SHKK-ve në SSD	Verifikime në SHKK për përmbushjen e kushteve për anëtarësimin në skemë  Automatizimi i sistemit të raportimit për shoqëritë e kursim kreditit (sistem raportues, shkëmbim të dhënash, kompensim).	Zbatim  -	Propozim	Zbatim
	Procesi i përfshirjes së SME-ve në SSD	Studim për vlerësimin e përfshirjes së SME-ve në skemën e sigurimit të depozitave	Studim	Studim	Analizë / Konkluzion
Identifikimi drejtimeve të reja për një administrim më të mirë të Institucionit	Administrimi i Institucionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të mirëqeverisjes, transparencës dhe komunikimit.	Vetëvlerësim për nivelin e përputhshmërisë së skemës së sigurimit të depozitave me parimet themelore për skema efektive të sigurimit të depozitave.  Strategji për zhvillimin e burimeve njerëzore	Miratim/Zbatim	Zbatim  Zbatim	-  Zbatim
	Rritja e përgjegjësisë sociale të institucionit, nëpërmjet angazhimit në projekte me ndikim në komunitet	Identifikimi i projekteve sociale, pjesë e të cilave do të bëhet Agjencia	Zbatim	Zbatim	Zbatim



